

9. Shëndeti mendor

Nëse gjëndesh në një moment vështirësie psiko-patologjike apo vuajtje psiqike (si përshëmbull nëse vuan nga ankthi, depresioni apo crregullime në të ngënë) mund ti drejtohesh shërbimeve të Shëndetit mendor në territorin ku jeton.

A. C'farë janë shërbimet mbi Shëndetin mendor për të rritur:

Shërbimet e Shëndetit mendor janë të shpërndarë në territor si Unità Funzionali Semplici (U.F.C)-qyteti i Firenze ka 4 U.F.S (Lagja 1-3, Lagja 2, Lagja 4 dhe Lagja 5)-dhe ofrojnë asistencë personave të prekur nga probleme psiqike personave që kanë mbushur moshën 18 vjecare ose më të mëdha.

Në bazë të tipologjisë, të ashpërsisë së sëmundjes dhe të urgjencës së gjëndjes klinike pacientët priten dhe kurohen në Ambulator (Centro di Salute Mentale), në Sruktura të ndërmjetme (Strutture Riabilitative Psichiatriche) ose në Spital (Servizi Psichiatrici di Diagnosi e Cura).

Shërbimet e shëndetit mendor janë të përbërë nga ekipe shumë profesioniste mjekësh, psikologësh, infermierësh, edukatorësh dhe asistente social të cilët, së bashku me pazientin dhe familjarët, merren me krijimin e një projekti teraupetik-rehabilitiv me asistencë të integruar dhe individuale.

B. Adresa Shëndeti mendor për të rritur në Firenze

Për vizitën e parë psikiatrike është e nevojshme kërkesa nga mjeku.

Kontakti i parë mund të jetë telefonik ose personalisht, sipas orareve.

Lihet një takim për një intervistë orientimi me infermierë dhe në të njëjtën ndërtesë edhe takimi me specialistin.

Takimi i parë me psikologun: kërkesa nga mjeku i familjes, takimi telefonik dhe /ose personalisht

Adresa në linkun e mëposhtëm:

<https://www.uslcentro.toscana.it/index.php/diagnosi-e-cura/620-i-servizi-per-la-salute-mentale/10698-salute-mentale-adulti>

Kliko në "Zona Firenze"

C. Dokumenta të nevojshme për shërbimin e shëndeti mendor për të rritur:

Dokument identiteti dhe karta e shëndetit

Shëndeti mendor tek fëmijët dhe adoleshentë

Nëse një fëmijë ose një i ri (deri në 18 vjeç) ka një problem të shëndetit mendor (si përshëmbull ankth, depresion, crregullim në të ngrënë, frik etj) prindi ose kush ka kujdestarinë mund ti drejtohet shërbimeve specifike për shëndetin mendor për fëmijë dhe adoleshentë.

A. C'farë janë shërbimet e shëndetit mendor për fëmijë e adoleshentë:

Shërbimet për shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve të USL Toscana Centro janë struktura territoriale të lidhura me Departamentin e Shëndetit Mendor dhe Varësive, te cilat prodhojnë e mbartin shërbime shëndetësore të Neuropsikiatrisë Infantile, Psikologji dhe Rehabilitimin me synim parandalimin, diagnostikimin, kurimin dhe shërimin e pjesës së popullsisë në shoshën 0-17 vjeçare.

B. Hyrja-zona fiorentina

Adresa dhe kontakte të Shëndetit Mendor të fëmijëve dhe adoleshëntëve

Adresa dhe kontakte në linkun më poshtë:

<https://www.uslcentro.toscana.it/index.php/diagnosi-e-cura/620-i-servizi-per-la-salute-mentale/10710-neuropsichiatria-infantile>

Kliko mbi "Zona Fiorentina"

Për hyrjen e parë për vlerësimin specifik të të kuptuarit për fëmijët nga mosha 7 deri në 14 vjeç është e nevojshme të kontaktohet CUP metropolitano me përshkrimin e mjekut "vizitë neuropsikologjike" me diagnozë "probleme në të kuptuar"

Për çdo kërkesë tjetër vizitash neuropsikiatrike, psikologjike ose neuropsikologjike është e mundur:

- të telefonosh numrin e telefonit 055 6934438 në ditët e hënë, e mërkurë dhe e premte nga ora 9.00 deri në 12.00
- duke derguar nje email me kërkesën dhe numrin e telefonit ku mund të kontaktoheni ne adresen
- salutementaleinfanzia.firenze@uslcentro.toscana.it
- Duke u paraqitur pranë qendrës në rrugën D'Annunzio 29 (front office kati i parë) nga e hëna në të premte nga ora 9.00 deri në 12.00

Dokumenta të nevojshme për të përfituar nga shërbimet e shëndetit mendor për fëmijë e adoleshentë:

Në takimin e parë është e këshillueshme paraqitja e recetës së vizitës specialiste

Duke qënë nje shërbim që i ofrohet minorëve është e detyrueshe konsensusi i të dy prindërve